

PROFILI I KOMPANISE

Shoqëria “ALBA BETON” është krijuar në vitin 1996 në fushën e prodhimit të materialeve të ndërtimit.

Aktualisht ajo zotëron pesë fabrika të prodhimit të betonit dhe një fabrikë të prodhimit të materialeve inerte, përkatësisht:

Në Tiranë funksionojnë tre fabrika të prodhimit të betonit dhe një fabrikë e prodhimit të materialeve inerte në Zallhër, në Durrës një fabrikë e prodhimit të betonit

Fabrikat e prodhimit të betonit janë:

- “ALBA BETON” në Prush, 1 km në dalje të Kombinatit, me kapacitet prodhimi 120 m³/ore.
- “ALBA BETON” në Kamez, 8 km larg Tiranës, me kapacitet prodhimi 80 m³/ore.
- “ALBETON 5” në Farke, me kapacitet prodhimi 120 m³/ore.
- Fabrika e betonit në Farke, 7 km larg Tiranës, me kapacitet prodhimi 120 m³/ore.
- “ADRIATIKA BETON” në Shkozë, në hyrje të Durrësit, me kapacitet prodhimi 80 m³/ore.

Për sa i përket kapacitetit të transportit dhe të hedhjes së betonit shoqëria jone zotëron:

Në Tiranë: 10 pompa betoni (33 - 47 m lartësi) dhe 30 autobetoniera (8 - 12m³);

Në Durrës: 3 pompa betoni dhe 12 autobetoniera;

Në Lushnjë: 1 pompe dhe 6 autobetoniera.

Disa nga objektet e rëndësishme që i janë besuar shoqërisë sone, sidomos nga supervizorë të huaj, kanë qenë:

- Parkingu i avionëve në aeroportin e Rinasit.
- Furnizimi me beton për ndërtimin e rezidencës së Ambasadës Britanike.
- Furnizimi me beton për rikonstruksionin e Ambasadës Amerikane.
- Pista e fluturimit të avionëve në Aeroportin e Rinasit.
- Ndërtimi i European Trade Center (ETC), ndërtim 18 katësh.

- Furnizimi me beton per ndertimin e dy Kullave Binjake.
- Ndertimi i kompleksit te banimit “Don Bosko”.
- Ndertimi i kompleksit te banimit “Kristal”.
- Furnizimi me beton per ndertimin e “Hotel Sheraton”, etj.

Si dhe objekte te veshtiresise se vecante te ndertuara per here te pare ne Tirane, si:

- Objekti 24 katesh i Firmes “Abau” prane stadiumit “Qemal Stafa”
- Objekti 12 katesh, me 5 kate parking nentokesor, i firmes “Artel” prane Librit Universitar.
- Objekti 26 katesh, me 5 kate parking nenetokesor, i firmes “TID”, prane Hotel “Drini”, i cili eshte ne fazen ndertimore.

Ne objektet e mesiperme pervec betoneve te zakonshem jane prodhuar me sukses betone te gjeneratave te reja si: betone speciale te nje cilesie te larte me (Rsh te larte), betone autokompatant, betone te padeptueshem nga uji, izobetone etj, duke perdorur aditive te gjeneratave te reja.

Gjithashtu shoqeria jone ka furnizuar e furnizon me beton nje numer te madh objektesh banimi, sociale dhe industriale qe ndodhen ne te gjithë zonen dhe periferine e Tiranës.

BESUESHMERIA e ndertuesve ndaj shoqerise sone rrjedh nga:

- **ORGANIZIMI** gje, qe vjen nga makinerite e pajisjet moderne, si dhe nga operatore e manovratore me eksperience te madhe ne kete fushe.
- **SHPEJTESIA** dhe **KORREKTESIA** ne furnizimin me beton, gje, qe vjen nga kapacitetet e medha teknike e transportuese, si dhe nga gadishmeria e larte teknike, qe sigurohet nga nje oficine moderne, 24 ore ne gadishmeri, duke evituar defektet e mundeshme ne objekt, ne nje kohe sa me te shkurter.
- **SERIOZITETI** eshte vleresuar vazhdimisht nga klientet tane, per sa i perket korrektesise ne dergimin e porosise si dhe te respektimit te sasise ekzakate te porositur.

Nje nga pikat kyce per shoqerine tone eshte **CILESIA**.

Cilesia e larte ne prodhimin e betonit sigurohet nga teknologji bashkekohore qe arrihet nga:

- Impiante betoni me komande dhe mates lageshtie.
- Depozitimi i inerteve sipas fraksioneve dhe origjines.
- Silloseve te depozitimit te cimentos, te pajisura me peshore elektronike, me kapacitet deri 300 ton per cdo fabrike.

Duke qene se shoqeria jone ka ne dispozicion te cdo fabrike, laboratore bashkekohore me pajisje te reja provash te materialeve te ndertimit, kryhen prova dhe kontrole te rregullta ditore te materialeve inerte e te betonit (bazuar ne normen Europiane EN-206), nga nje personel tekniko – inxhinierik me eksperience te gjate ne prodhimin e betonit dhe i specializuar brenda dhe jashte vendit.

Hartimi i recetes se klasave te betonit, qe prodhohen ne fabrike, kryhet me ndihmen e nje programi kompjuterik, pasi futen te dhenat per te gjitha materialet perberes te betonit, bazuar ne analizat paraprake te tyre.

Betoni i prodhuar ne baze te ketyre recetave, kontrollohet cdo dite duke mbajtur kampionet prove dhe duke kryer kontrollin e betonit te fresket (konsistencen, porozitetin) si dhe kontrollin e Rezistences ne Shtypje. Sipas rezultateve te ketyre provave, klientet pajisen me Certificate Cilesie, mbi Rezistencen ne Shtypje 7 dhe 28 ditore, per betonin e furnizuar nga kjo fabrike.

Besueshmeria, qe ka gjetur aprovim ne perfaqesuesit e firmave ndertuese dhe investitoreve, te cilet e kane vleresuar punen e shoqerise sone te nje niveli te larte, duke e konsideruar si nje partner te rendesishem ne biznesin e tyre, per sa i perket fushes se prodhimit dhe tregtimit te betoneve, e kane bere shoqerine tone **Lider**, ne kete fushe, ne vendin tone.